

FORUMI KOSOVAR I AFTEKISE SE KUFIZUAR (KDF)

Pasqrat financiare me Raportin e Auditorëve të Pavarur

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja	
	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e pozitës financiare	
Pasqyra e fitimit dhe humbjes	
Pasqyra flukseve të parasë	
Shënimet e pasqyrave financiare	4-9



N.Sh. "Balluku&Zhaveli", General Partnership

Raporti i auditorit të pavarur

Për: Menaxhmentin e Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF)

Ne kemi audituar pasqyra financiare të Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF) (apo "ORGANIZATA"), të cilat përmbajnë pasqyrat e pozicionit financiar me tatën 31 dhjetor 2021, dhe Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin mbaroi më pas, dhe shënimet në pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF), për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021 janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjet përkatëse në Kosovë.

Baza për opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe kontrollin e tillë që menaxhmenti përcakton është i domosdoshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.



N.Sh. "Balluku&Zhaveli", General Partnership

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen, nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tomorr Zhaveli
Auditor Ligjior



Balluku & Zhaveli

Prishtina, Kosova
30 Mars 2022

**FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Deri me 31 Dhjetor 2021

(Shumat në EUR)

Me 31 Dhjetor	<i>Shënime</i>	2021	2020
Pasuritë			
Pasuritë afatshkurtra			
Parat e gatshme dhe ekuivalente te saj	3	2,587	25,892
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera		690	
Totali i pasurive afatshkurtra		3,277	25,892
Pasuritë afatgjata			
Pajisjet e zyrës		-	-
Totali i pasurive afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë		-	25,892
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogarite e pagueshme		-	-
Te pagueshme te tjera	4	-	74
Te ardhurat e shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		-	74
Fondet			
Bilanci i hapjes		25,818	7,993
Fitimi/(humbja)		(22,541)	17,825
Total Fondet		3,277	25,818
Gjithsej detyrimet dhe fondet		3,277	25,892

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit

më 30 Mars 2022 nga

Bujar Kadiu
Kryetar



Anida (Haliti) Gashi
Menaxhere financiare

FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor 2021
(Shumat në EUR)

Për vitin që mbaron ne 31 Dhjetor	<i>Shënime</i>	2021	2020
Te hyrat			
Te hyrat nga Donacionet	5	125,359	209,125
Te hyrat e shtyra			-
Totali i te Hyrave		125,359	209,125
Shpenzimet	6		
Shpenzimet direkte të Projekteve		(16,667)	(129,003)
Shpenzimet e personelit		(114,089)	(48,485)
Shpenzimet operacionale dhe administrative		(17,144)	(13,668)
Shpenzimet tjera			(144)
Totali i Shpenzimeve		(147,900)	(191,300)
Fitimi/(Humbja)		(22,541)	17,825

FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)
PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE

Për vitin që mbaron ne 31 Dhjetor 2021
(Shumat në EUR)

Për vitin qe mbaron ne 31 Dhjetor	2021	2020
Rrjedhja e parasë prej aktiviteteve operacionale		
Fitimi/(humbja) neto për vitin	(22,540)	17,825
Rregullimet ne pasuritë dhe detyrimet operacionale		0
Zhvlerësimi		0
(Rritjet)/Zvogëlimet në llogarit e arkëtueshme	(690)	0
(Rritjet)/Zvogëlimet e llogarit tjera te parapagimeve		0
(Rritjet)/Zvogëlimet e parapagimeve		0
(Rritjet)/Zvogëlimet e detyrimet e pagave		0
(Rritjet)/Zvogëlimet e detyrimet tjera	(74)	74
(Rritjet)/Zvogëlimet e te ardhurat e shtyra		0
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operacionale	(23,305)	17,899
Rrjedha e parasë prej aktiviteteve investuese		
Shtesa në pasurit afatgjata		0
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		0
Neto Rritjet/(zvogëlimet)	(23,305)	17,899
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme në fillim të vitit	25,892	7,993
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme në fund të vitit	2,587	25,892

FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)

Shënime në pasqyrat financiare

Për vitin që mbaron në 31 Dhjetor 2021

(Shumat në EUR)

1. TË PËRGJITHSHME

"Forumi Kosovar i aftësisë së Kufizuar" për organizate për shërbime sociale-edukative, që mund të njihet edhe si FKAK apo KDI, Prishtinë është organizate joqeveritare jo profitabile, sipas dëfinimit të dhënë në bazë të nenit 1 pika 1.5 të Statutit bazuar në nenin 5 paragrafin 2. nenit 6 dhe 8 të Ligjit nr. 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Me aktin e regjistrimit nr. 5116500-4, me nr. Fiskal 601739991, është regjistruar në Ministrinë e Administratës publike - Departamenti për Regjistrimin e OJQ, date 19.01.2017 me emrin "Forumit Kosovar i aftësisë së Kufizuar", është themeluar për qëllime që të bëjë:

- Sigurimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në vendi-marrje dhe krijimin e politikave që bazohen në të drejtat e personave me aftësi të kufizuar,
- Promovimi i interesave të përbashkëta të lëvizjes dhe mbështetja e anëtarëve,
- Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të "Forumit Kosovar i aftësisë së Kufizuar" dhe fuqizimi për rritje të bashkëpunimit,
- Ngritja e vetëdijes së shoqërisë mbi aftësinë e kufizuar,
- Lobimin për ratifikimin e Konventës ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar dhe harmonizimi i Legjislacionit të Kosovës me standardet dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, që të gjitha ligjet dhe politikat për aftësinë e kufizuar të jenë në harmoni me konventën,
- Anëtarësimi në Forumin Evropian të Aftësisë së kufizuar (EDF) dhe organizata të tjera ndërkombëtare,

Përveç këtyre qëllimeve organizata do të ndërmarrë edhe këto aktivitete:

- Organizimi i trajnimeve dhe aftësimeve të ndryshme profesionale,
- Publikimi i materialeve dhe literaturave të ndryshme,
- Organizimi i punëtorive me karakter edukative dhe sociale,
- Veprimtari tjera në funksion të përmbushjes së qëllimeve në harmoni me Ligjet në fuqi.

Selia e Organizatës është Rr. Tringë Smaili Nr.47, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF) është një organizatë ombrellë dhe mekanizëm gjithëpërfshirës i tetë organizatave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

KDF është themeluar me asistencën e zyrës së Unionit Evropian në Kosovë dhe Forumit Evropian të Aftësisë së Kufizuar, si një organizatë që përfaqëson, mbrojnë dhe promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të unifikuar, pa asnjë dallim.

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar në kuadër të saj ka të anëtarësuar gjithsej tetë (8) organizata të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, të cilat janë:

- Shoqata e të Verbërve të Kosovës;
- Shoqata Kosovare e të Shurdhërve;
- Down Syndrome Kosovo;
- HandiKos;
- Shoqata e Autizmit;
- Handikep Kosova;
- OPFAKOS-Organizata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara;
- Klubi "Dëshira".

Forumi, ka për qëllim të unifikojë lëvizjet, politikat dhe strategjitë e organizatave anëtare për të arritur një përfaqësim më të lartë të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë; dhe një gjë të tillë mundohet ta arrijë përmes zhvillimit dhe implementimit të projekteve të ndryshme, të cilat mbështeten nga donator të ndryshëm vendor dhe të huaj.

FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)

Shënime në pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në EUR)

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME të KONTABILITETIT

2.1 Baza për prezantim

Për qëllime të regjistrimit financiar, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF) përdor metodën akruale të kontabilitetit për raportimin e marrjes dhe disbursimit të fondeve. Sipas kësaj metode të raportimit të transaksioneve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet njihen kur fitohen dhe ndodhin.

2.2 Monedha funksionale

Forum i Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF) kryen transaksione në Euro. Të gjitha shumat e raportuara në raportin financiar janë përkthyer në EURO duke përdorur kurset e publikuara të këmbimit në fuqi në datën e transferimeve të pranuar.

2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të organizatës janë llogari të arkëtueshme nga donatorët.

2.4 Llogaritë e pagueshme

Shërbimet komunale, shpenzimet e projektit dhe të pagueshme për organizatat partnere të cilave KDF qëndron si dhënësi i janë paraqit në pasqyrat financiare si llogari të pagueshme.

2.5 Të hyrat e shtyra

Të Hyrat e Shtyra janë të hyrat / donacionet për të cilat paratë e gatshme janë pranuar nga organizata, por ende nuk janë fituar. Si pasojë, kjo ndodh kur Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (KDF) pranon parapagim për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen.

2.6 Taksat e të ardhurave

Organizata është një organizatë joqeveritare (OJQ), donacionet e të cilave kanë marrë në vitin raportues janë zbatuar për qëllime jofitimprurëse. Sipas ligjit Nr.03 / L162 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, OJQ-të, të ardhurat totale të të cilave u përdorën për qëllimet e tyre jofitimprurëse, përjashtohen nga taksat.

FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË SË KUFIZUAR (KDF)

Shënime te pasqyrave financiare

Për vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2021

(Shumat ne EUR)

3. Paraja e gatshme dhe ekuivalenti i parasë së gatshme

Deri me 31 Dhjetor	2021	2020
PCB -156	2	2
PCB -165	50	20,707
PCB -1192	2,536	5,183
Arka	0	0
Totali	2,587	25,892

4. Llogarite e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Deri me 31 Dhjetor	2021	2020
Llogari tjera te arkëtueshme	690	0
Totali	690	0

4. Llogarite e pagueshme

Deri me 31 Dhjetor	2020	2020
Tatimi ne qira	-	74
Totali	-	74

5. Të hyrat

	2021	2020
ABILIS	4,494	-
Ambasada Ceke	10,655	-
ATRC/USAID	-	1,170
B&D Comany:B&D Company	6,500	-
CDF	-	6,819
CDF	43,107	-
CDF 2020	-	5,000
DF - SIDA	-	50,157
DVV International	-	7,000
EYE:	-	500
KCSF	-	4,900
KEP TRUST	-	1,000
KEP TRUST	2,000	-
KFOS	-	5,000
Komision European	2,092	4,039
Kuvendi i Kosovës	-	3,050
Ministra e Punës dhe Mireqenis Sociale	-	400
PIN	-	14,913
Save the Children	21,000	-
Save the Children	-	12,600
UNFPA	-	18,567
UNICEF	-	4,770
UNICEF 2020	-	34,322
UNICEF 2020/21	33,165	33,165
USAID	1,850	-
W Tjera (Forumi)	496	1753
	125,359	209,125

6. Shpenzimet

	2021	2020
Projektet	16,667	129,003
Shpenzimet e personelit	114,089	48,485
Shpenzimet e zyrës	10,622	7,397
Shërbimet profesionale	800	194
Shpenzimet e udhëtimit	200	508
Shpenzimet e automjetit	2,891	2,675
Shpenzimet e komunikimit	1,573	1,948
Komunalit	753	946
Shpenzimet tjera operative	305	144
Gjithsej Shpenzimet	147,900	191,300

7. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare të Kompanisë.